



Udhëzues për fëmijë dhe prindër – ndëshkimi fizik i fëmijëve

Shkup, 2016

ISBN 978-608-4603-08-5

Titulli: Udhëzues për fëmijë dhe prindër kundër ndëshkimit fizik të fëmijëve

Botues: Ambasada e parë e fëmijëve në Botë Megjashi- Republika e Maqedonisë

Drejtor ekzekutiv dhe themelues : m-r Dragi Zmijanac

Redaktore: Jana Zengovska

Lektura: Armend Nuhiu

Recenzues: doc. d-r Sasho Koçankovski

Përpunimi grafik dhe shtypja: „Bato dhe divajn“

Përkthimi në shqip : Armend Nuhiu

Adresa e botuesit:

Ambasada e parë e fëmijëve në Botë Megjashi- Republika e Maqedonisë

Rr. Kosta Novakoviç nr.22a, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë

Tel/faks +389 2 2465 316

E-mail: info@childrensembassy.org.mk

www.childrensembassy.org.mk

Përmbajtja :

Parathënie.....	4
Hyrie	6
<u>Çka është keqtrajtimi fizik?</u>	7
<u>Pse disa fëmijë janë të pikëlluar?.....</u>	8
<u>Disa nga shenjat trupore janë:.....</u>	9
<u>Siellja e fëmijës që është keqtrajtuar fizikisht:.....</u>	9
<u>Çka mund të bësh që që të mbrohesh?</u>	10
<u>Cilët janë ata prindë/të rritur që i lëndojnë fëmijët e tyre?</u>	11
<u>3. Çfarë pasojash le rrahja te fëmijët</u>	11
<u>4. Veprimi gjatë keqtrajtimit të fëmijëve</u>	13
<u>4.1Njohja dhe zbulimi i keqtrajtimit dhe anashkalimit.....</u>	13
Si të veprohet gjatë dyshimit për keqtrajtim fizik të fëmijës?.....	14
Literatur.....	15

Parathënie

Publikim jashtëzakonisht i rëndësishëm, e cila në një gjuhë të lehtë dhe të kuptueshme flet për ndëshkimin trupor, keqtrajtimin e fëmijëve, për rëndësinë e prindërisë së përgjegjshme në edukimin dhe në përgjithësi në zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës.

Ky publikim ka për qëllim që ta përmbushë hapësirën në edukimin dhe përgatitjen e vetëdijes për këto dukuri të padëshirueshme, të cilët janë në rritje te fëmijët në Republikën e Maqedonisë. Është e dedikuar në rradhë të parë për fëmijët, prindërit, arsimtarët, mësimdhënësit dhe edukatorët e institucioneve publike dhe private të cilët punojnë me fëmijët, por edhe për të gjithë ata që janë të përfshirë në arsimimin joformal.

Këtë udhërrëfyes mund t`a shfrytëzojnë edhe anëtarët e shërbimeve profesionale të këtyre institucioneve arsimoro-edukative, qendrat për punë sociale, policia, shëndetësia...

Nga ky udhërrëfyes dobi edhe më të madhe do të kenë fëmijët, prindërit, mësimdhënësit, psikologët, pedagogët, punëtorët socialë dhe mjekët, të cilët pas dyshimit ose identifikimit të keqpërdorimit ndaj fëmijës, tregojnë për obligimin e tyre që të ndër marrin masa adekuate për denoncimin e tyre në institucionet kompetente /SOS qendrat, me qëllim të mbojtjes nga keqtrajtuesit.

Poashtu mund të shfrytëzohet edhe për qëllime arsimore në institucionet edukative-arsimore në mësimin joformal.

Informatat e shumta të cilat janë ofruar për ndikimin negativ të dhunës në zhvillimin e përgjithshëm të fëmijëve, si dhe mënyrat dhe format e edukimit, do t'u ndihmojë prindërve që ta ndryshojnë dhe përmirësojnë sjelljen e tyre, jo vetëm ndaj fëmijëve të tyre por edhe ndaj fëmijëve në përgjithësi.

Sepse qëllimi i prindërisë nuk është vetëm mbrojtja e fëmijëve, por edhe krijimi i ambientit për zhvillimin e tyre të plotë, ku do të mund që ti realizojnë potencialet e tyre në gëzim, dashuri, mirëkuptim, respektim dhe mbështetje.

Me kënaqësi e rekomandoj këtë udhërrëfyes.

13.06.2016
Manastir

Doc. D-r Sasho Koçankovski
Doktor i shkencave psikologjike dhe
terapeut i Geshtalt-it

Hyrje:

Ky doracak është i dedikuar për prindërit dhe fëmijët. Është me rëndësi që fëmijët ta njohin ndëshkimin trupor si dhunë, si dhe të inkurajohen që të njëjtin ta raportojnë.

Në doracak janë dhënë instruksione të shkurtëra për fëmijët, me qëllim që ti njohin shenjat implicite të dhunës në të cilat janë të nënshtruar moshatarë të tyre dhe ti denoncojnë ato. Shumë shpesh fëmijët nuk janë të informuar për procedurat e paraqitjes kur bëhet fjalë për cilëndolloj forme të dhunës ose të thyerjes së të drejtave të tyre dhe si realizohet procedura kur e njëjta do të paraqitet. Duke mos pasur informata të mjaftueshme ata nuk marrin guxim që ti informojnë institucionet përkatëse për gjendjen në të cilën gjenden, dhe njëkohësisht vazhdimisht frikësohen nga ana e përdhunuesit se nëse paraqesin rastet, do të keqtrajtohen në mënyrë plotësuese edhe nga institucionet.

Do të dëshiroinim që njëkohësisht ti inkurajojmë edhe prindërit që ti drejtojnë fëmijët e tyre që të kujdesen për vet, që të mos tolerojnë asnjë lloj të dhunës dhe mos ta praktikojnë dhunën. Është me rëndësi që fëmijët të zhvillojnë qasje kritike ndaj padrejtësisë dhe empati ndaj atyre që janë keqtrajtuar por para së gjithash, të mësohen të kujdesen për veten dhe për sigurinë e tyre.

Çka është keqtrajtimi fizik?

E drejta e fëmijëve që të mbrohen nga keqtrajtimi fizik është shënuar në nenin 19 të Konventës për mbrojtje të fëmijëve.

Shtetet- anëtare do të ndërmarrin të gjitha masat adekuate juridike, administrative, sociale dhe arsimore për shkak të mbrojtjes së fëmijëve nga të gjitha llojet e dhunës fizike dhe mentale, lëndimeve ose keqtrajtimit, anashkalimit dhe sjelljes anashkaluese, maltretrimit dhe eksploatimit, përfshirë këtu edhe eksploatimin seksual, përderisa për atë kujdesen prindërit, kujdestarët ligjorë ose persona tjerë të cilëve u është besuar kujdesi për fëmijën

Në Protokolkin e përbashkët për veprim në rastet e keqtrajtimit dhe anashkalimit të fëmijëve, në faqen 36, është shënuar se -„Keqtrajtimi fizik është definuar si përdorim me qëllim i forcës fizike kundër fëmijës e cila shkakton lëndim, ose ekzistojnë gjasa që të dëmtohet shëndeti, zhvillimi ose dinjiteti i fëmijës. Kjo përfshin: goditje, rrahje, shqelmim, dridhje, mbytje, kafshim, djegie me ujë të nxehtë, helmim ose asfiksion“.

-Sipas Komiteti të OKB për të drejtat e fëmijës:- Çdo ndëshkim në të cilin përdoret fuqia fizike me qëllim që të shkaktohet nivel i caktuar i dhimbjes ose mospëlqimit, pa marrë parasysh sa e vogël është dhimbja, paraqet ndëshkim trupor të fëmijës“.

Por, për fat të keq ndëshkimi më shpesh i përdorur për disiplinimin dhe edukimin e fëmijëve në shtëpi është ndëshkimi trupor i fëmijës i cili mund të lë pasoja të rënda dhe të përjetshme në zhvillimin dhe rritjen optimale të fëmijëve.

Pse disa fëmijë janë të pikëlluar?

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës e Kombeve të Bashkuara është Marrëveshje për të drejtat e njeriut në të cilën përcaktohen të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale, shëndetësore dhe të drejtat kulturore të fëmijëve. Konventa në përgjithësi përcakton një fëmijë si çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë vjet, përveç nëse sipas ligjit të një shteti të caktuar moshë madhore është arritur më herët.

Marrë dhe përshtatur nga Protokoli i përbashkët për veprim në rastet e abuzimit dhe neglizhimit të fëmijëve, Trupi Nacional Koordinues për Mbrojtjen e Fëmijëve nga abuzimi dhe anashkalimi i fëmijëve, 2014

Rekomandimet e Komitetit të OKB-së nga ana e Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, qershor 2010

[http://www.unicef.org/tfyr-macedonia/macedonian/CRC.C.M1KD.ConcludingObservationsMK\(1\).pdf](http://www.unicef.org/tfyr-macedonia/macedonian/CRC.C.M1KD.ConcludingObservationsMK(1).pdf)

Shumica e prindërve i duan fëmijët e tyre sepse fëmijët sjellin vetëm gëzim. Fëmijët janë të çmueshëm.

Por, ndonjëherë prindërit, ose të rriturit tjerë që kujdesen për fëmijët, mund t'i lëndojnë ata. Më së shpeshti at i RRAHIN fëmijët çdoherë kur fëmijët do të bëjnë diçka për të cilën prindërit vlerësojnë se nuk është në rregull. Ndonjëherë i rrahin edhe pa ndonjë arsye, thjesht sepse janë zemëruar në punë ose janë grindur me dikë.

Prindërit të cilët i rrahin fëmijët dëshirojnë që ta fshehin këtë. Shpesh i kërcënojnë dhe i frikësojnë se nëse i tregojnë dikujt çka ndodh në shtëpi do t'i rrahin edhe më shumë dhe do i përzënë nga shtëpia. Për këtë shkak, fëmijët frikësohen të tregojnë se mami dhe babi i lëndojnë.

Ko fëmijë çdo ditë e pyesin veten se PSE PIKËRISHT MUA më ndodh kjo. Çdo ditë bëhen më të pakënaqur.

Por megjithatë, në sjelljen e fëmijës ekzitojnë disa shenja të cilat do të na ndihmonin që të zbulojmë nëse ndonjë fëmijë është lënduar dhe t'i ndihmojmë në kohën e duhur:

Disa nga shenjat trupore janë :

- Vende të mavijosura të qarta ose të paqarta dhe shtypje të pjesëve të mbuluara të trupit të fëmijës(barku, shpina, pjesa e jashtme e nëngjurit dhe mbigjurit),
- plagë
- Skuqje dhe mavijosje në formë të objekteve (litar, rrip, shkop, pëllëmbë)
- Flokë të shkulura, dhëmbë të cilët mungojnë
- Kafshime
- Djegie shkaktimi i të cilëve nuk mund të spjegohet (nga cigaret, nga lëng i nxehtë, në formë të dorezës, në formë të çorapeve, nga rryma)
- Të thyera, të përdredhje ose lëndime të kokës që nuk mund të spjegohen
- Helmime me helme, mjete korrozive, substanca psikoaktive

Sjellja e fëmijës të keqtrajtuar fizikisht:

- Frikë nga kontakte me të rriturit
- Frikë nga prindi ose anëtar tjetër i familjes
- Frikësohet nga qarja e fëmijëve të tjerë
- Lehtë nervozohet nga ngacmimet
- Shfaq skajshmëri në sjellje – agresion ose tërheqje

- Anksiozitet i tejshfaqur
- Nuk lejon që të kontrollohet
- Nuk duron kontakt fizik ose prekje
- Iq nga shtëpia
- Nuk mund të krijojë marrëdhënie të mirë me moshatarë
- Ka vetërespekt të ulët

Këto fëmijë për fat të keq nuk mund të jenë të lirë dhe të gëzuar si shokët e tyre.

Çka mund të bësh që të mbrohesh?

Nëse dikujt nga ju i ndodh që prindërit ose të rritur të tjerë tu lëndojnë, ndoshta do të mendoni se ju jeni fajtor për këtë. Është me rëndësi të dini se fëmijët asnjëherë nuk janë fajtorë për sjelljen e tillë ndaj tyre! Askush nuk guxon që t`u rrahë!

Nëse jeni në rrezik duhet të fshiheni në vend të sigurtë- mbylluni në dhomën tuaj, në banjo, ikni te fqinji ose te ndonjë i rritur tjetër të cilit i besoni dhe menjëherë lajmëroni policinë.

Nëse dhuna tashmë ka ndodhur, besohuni ndonjë personit të rritur të cilit i besoni (arsimtar, fqinj, farefis) dhe pastaj sigurisht që mund ta lajmëroni policinë.

Cilët janë ata prindër/ të rritur të cilët i lëndojnë fëmijët e tyre?

Sipas statusit fizik, arsimor ose socio-ekonomik të prindot nuk mund të supozoored физичкиот, обрсе cili prind e keqtrajton fizikisht fëmijën e tij:

Por ekzistojnë formularë t'ë caktuar të sjelljes të këta prindër ose të rritur me ndihmën e të cilëve mund ta supozojmë keqtrajtimitin e mundshëm të fëmijës.

Sjellja e të rriturit:

- Zemërim, mosdurim, shpesh humbin kontrollën e sjelljes
- Duken të pasigurtë në aspekt të të gjendjes së fëmijës
- E vlerësojnë fëmijën si të keq dhe si shkak për të gjitha problemet e tij jetësore
- Kanë rrezistencë ndaj bisedës për gjendjen e fëmijës ose familjes
- Në çdo pyetje sheh me dyshim
- Shfrytëzon mënyra të disiplinimit joadekuate për moshën e fëmijës
- Jep shpjegime jo të logjikshme, kundërthënëse ose jo bindëse për lëndimet e fëmijës ose aspak nuk jep shpjegime
- Nuk tregon kuptim të mjaftueshëm ose aspak kuptim për zhvillimin normal të fëmijës
- Ka pritje nga fëmija të cilat janë joadekuate për moshën e tij.

3. Çfarë pasojash lë rrahja të fëmijët

Për këto fëmijë është karakteristike se kur lëvizin e tregojnë fuqiinë e tyre fizike në mënyrë dominante. Kanë dukje agresive agresive të fytyrës, kohë pas kohe godasin me grushta nëpër mure ose në kundërshtarin e paramenduar. Prindërit e këtyre fëmijëve vlerësojnë se ndëshkimi trupor është mënyra e vetme e mirë dhe e vetme për edukim. Njëkohësisht edhe këto prindër kanë qenë të edukuar në mënyrë të tillë dhe gjatë fëmijërisë së tyre

janë përpjekur vazhdimisht të mos gabojnë diëka dhe të rrihen. Në këto familje nëna vlerëson se fëmija nuk guxon që të rrihet, por kur është aty babai i cili është përdhunuesi „kryesor“ nëna shfrytëzon mënyra tjera të ndëshkimit dhe vazhdimisht i kërcënohet duke përdorur fjalë ofenduese dhe kërcënime. Këtij fëmije i cili është shpesh viktimë e rrahjes, prindërit nuk i parashtrojnë kërkesa të qarta dhe nuk i tregojnë ëka saktësisht kërkohet nga ai, dhe njëkohësisht nuk i tregohet se çka ka gabuar. Nëse këtë fëmijë e pyesim se cili ka qenë shkaku i rrahjes së fundit, nuk do të dijë të tregojë. Nëse nga ana tjetër i pyesim prindërit pse nuk e lavdërojnë fëmijën e tyre kur ai do të bëjë diçka të shkëlqyeshme, ata do të përgjigjen se do ta lavdërojnë vetëm kur fëmija do ta ndryshojë sjelljen e tij. Në shikim të parë duket se ky fëmijë ka mendim të mirë për veten, por jashtësia e tij nuk përputhet me ndjenjat e vërteta të këtij fëmije. Për shkak të mesazheve që i merr nga prindërit e tij ky fëmijë ndjehet i pafuqishëm, i pavlefshëm për dashuri dhe kujdes, nuk i beson askujt dhe jeton në frikë të vazhdueshme se dikush do ta godasë. Ky fëmijë çdo prekje e kupton si ndëshkim trupor. Dukja dominante është vetëm maskë me qëllim që dikush mos i afrohet dhe ta sulmojë. Ky fëmijë ka problem me procesin e pavarësimit dhe funksionimit në mjedisin shoqëror. Fëmijët të cilët janë të ndëshkuar me rrahje barazohen me agresorin, me atë që i keqtrajton dhe në këtë mënyrë do të mundohen të bëhen të njëjtë si agresori. Këta fëmijë sjellin vendimin se kurrë nuk do të jetojnë më në dhunë, dhe se kur do të rriten do i kundërvihen babait të tyre apo dikujt tjetër i cili e ndëshkon. Por, nga ana tjetër këta fëmijë konkludojnë se janë të pafuqishëm dhe të destinuar që çdoherë të jenë viktimë. Për këto arsye mund të jenë të tërhequr, vazhdimisht të frikësuar me qëllim që mos të provokojnë që dikush ti sulmojë ose lëndojë. Këta fëmijë nga sjellja e tyre e përjashtojnë çdo mundësi se ata do të mund të provokojnë dhunë.

4. Veprimi gjatë keqtrajtimit të fëmijëve

Sipas Protokolit të përbashkët për veprim në raste të keqtrajtimit dhe anashkalimit nga viti 2011, veprimi nënkupton:

1. Njohje nga ana e personave profesionalë, nëpërmjet zbulimit direkt ose njohje të indikatorëve të keqtrajtimit dhe anashkalimit të fëmijëve ose dyshime për të njëjtat;
2. Denoncim i keqtrajtimit dhe anashkalimit si dhe dyshimit për keqtrajtimit dhe anashkalimit në qendrën për punë sociale, në polici ose në prokurorinë publike;
3. Vlerësim të gjendjes, nevojave dhe rrezikut nga keqtrajtimit dhe anashkalimi i fëmijës dhe familjes pas raportimit të rastit në Qendrën për Punë Sociale (QPS)

Koordinimin e procesit e ka dhe e mban organi kompetent ose qendra për punë sociale.

4.1 Njohja dhe zbulimi i keqtrajtimit dhe anashkalimit

Zbulimi i keqtrajtimit dhe anashkalimit të fëmijëve është njëri ndër hapat më të ndjeshëm dhe njëkohësisht edhe hapi i parë në drejtim të mbrojtjes së fëmijëve.

Nga mënyra e njohjes varet edhe procedura e mëtejshme dhe rrjedha e saj. Zbulimi zakonisht bëhet nga persona profesionale të cilat janë në kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijët dhe kujdesen për ta si (edukatorët, punëtorët shëndetësore, motrat medicinale, mjekët, arsimtarët,psikologët, pedagogët, punëtorët socialë etj.)

Si të veprohet gjatë dyshimit për keqtrajtim fizik të fëmijës?

Është shumë me rëndësi që të gjithë ata që janë në kontakt me fëmijën për të cilën ekziston dyshim se është keqtrajtuar, pa informata të qarta për atë, të njëjtën ta paraqesin në Qendrën për politikë sociale ose në numrin 15 505 në Ministrinë për punë dhe politikë sociale të Republikës së Maqedonisë, në polici ose në SOS telefonin për fëmijë dhe të rinj 0800 1 22 22 pranë Ambasadës së parë të fëmijëve Megjashi.

Njëkohësisht dëshirojmë të theksojmë se bisedat me fëmijën, për të cilën ekziston dyshim se është keqtrajtuar, mund ta bëjnë persona profesionale të cilët do ta marrin parasysht situatën e plotë të fëmijës dhe familjes së tij.

Çdo bisedë plotësuese nga ana e personave tjerë të cilët kanë qenë në kontakt me fëmijën paraqet viktimizim të fëmijës.

Literatura:

- 1. Protokoli i përbashkët për veprim në rastet e keqtrajtimit dhe anashkalimit të fëmijëve, 2014, Qeveria e Republikës së Maqedonisë**
- 2. Libër i vogël për prindërit e mëdhenj 2009(Z. Milivojeviq , K. Bilban, B.Kokelj. M. Kramberger, T.Steiner, B. Kozhuh)**
- 3. Psikologjia zhvillimore , 2004, (O. Мурцева Шкарик)**